


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 2285 REP
Nr. 1324 KOL

MARREVESHJE PENGU
Nr. 2243 /2, Date 20.07.2016



Sot, me date 20/7/2016, para meje Bajram Halili, noter ne Dhomen e Noterise Tirane, me adrese ne 13000 4000, u paraqiten personalisht per te redaktuar kete kontrate palet:

1. Shoqeria aksionere "BANKA CREDINS" SH.A, shoqeri shqiptare e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tirane me Vendimin Nr. 28969, Date 31.01.2003, regjistruar ne organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT Nr. K 316088010, si dhe me Licensën e Bankës së Shqipërisë Nr.16, date 31.03.2003, e përfaqësuar nga **Drejtori Rajoni Tirana 1, znj. Blerta Tela**, lindur me date 12.05.1983 ne Korçe me Letërnjoftim nr.029683787 me numer personal I35512066C, banuese ne Tirane, te njohur personalisht para meje, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe nga **Analiste Kredie SME, znj. Lusena GJONDEDAJ**, lindur me date 13.02.1988, ne Vlore, me Letërnjoftim nr.029820150 me numer personal I85213090W, banuese ne Tirane, te njohur personalisht para meje, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, (ne vazhdim do te quhet "Kolateralmarres / Pengmarres");

2. **z. Gezim Halili**, atesia Bajram lindur me 14.09.1964, ne Kukes, dhe banues ne Tirane me karte identiteti nr. 028019967 dhe nr. personal G40914097H, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhen **Kolateral dhenes / Pengdhenes**).

3. **znj. Albana Halili**, atesia Ahmet lindur me 05.12.1969 ne Durres, dhe banues ne Tirane me karte identiteti nr. 032912228 dhe nr. personal G96205042K madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhen **Kolateral dhenes / Pengdhenes**).

Palet ne kete kontrate kane rene dakord per perpilimin dhe nenshkrimin e kesaj kontrate me termat dhe afatet e meposhtme:

Neni 1 Te pergjithshme

1.1 Ndermjet shoqerise tregtare "Banka Credins" sh.a, dhe shoqerise tregtare "Griald" Shpk, eshte lidhur nje **Kontrate Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr. 226 kol, date 08.02.2016 per shumen 15.000.000 Leke (pesembedhjetë milion Leke), me afat 12 muaj.**

1.2 Per efektet e sigurimit te permbushjes se detyrimeve qe rrjedhin nga Kontrata e lartpermendur pershkruar ne piken 1.1, **z. Gezim Halili**, vendos peng mbi 26 % te Kuotave te kapitalit qe zoteron prane shoqerise "Hydroalbania" Shpk, per kete qellim perpilohet kjo kontrate pengu me termat dhe kushtet si me poshte.

Neni 2 Baza Ligjore

Kjo kontrate hartohet bazuar ne nenet 530 e vijues, nenet 546 e vijues dhe nenet 681 e vijues te Kodit Civil, dhe legjislacionit te aplikueshem per te rregulluar kete marredhenie kontraktore.

Neni 3 Objekti i Kontrates

3.1 Kjo kontrate ka per objekt lenien peng te Kuotave te kapitalit qe **z. Gezim Halili** zoteron ne shoqerine "Hydroalbania" Shpk, prone e Kolateral dhenesit ne favor te Kolateralmarresit si garanci per permbushjen e detyrimit qe rrjedhin nga **Kontrate Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr. 226 kol, date 08.02.2016.**

Neni 4 Afati i Pengut

4.1 Kjo kontrate hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit nga palet dhe do të jetë në fuqi me afat vlefshmerie deri në shlyerjen plotë dhe përfundimtare të kredisë së bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera të parashikuara, që rrjedhin nga **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016** si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime të saj, apo dhe në rast ristrukturimi të kontratës së overdraftit si me sipër permendëm, transformimi nga linjë në kredi, transformimi nga garanci kontrate në kredi, etj.

Neni 5 Garancite

5.1 Kolateraldhënesi garanton dhe siguron se është pronar legjitim dhe i vetëm i Pengut.

5.2 Kolateraldhënesi garanton dhe siguron se lidhur me pronesinë e pengut, nuk ka asnjë pretendim nga palët e treta, pengu është teresisht prone e pendhënesit dhe ai e ve pengun atë të lirë nga çdo kufizim dhe në mënyrë të pakushtëzuar nga çdo barrë apo e drejtë reale.

Neni 6 Detyrimi i siguruar

6.1 Kolateraldhënesi siguron me pengun duke përfshirë po pa u limituar në keto, të gjitha detyrimet së bashku me penalitetet, interesat, komisionet, dhe shpenzimet e tjera të parashikuara që rrjedhin nga **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016, në shumën 15.000.000 leke**, të marrë pranë "Credins Bank" sh.a, si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime të saj, apo dhe në rast ristrukturimi të kontratës së overdraftit si me sipër permendëm, transformimi nga linjë në kredi, transformimi nga garanci kontrate në kredi, etj.

Neni 7 Të Drejtat dhe Detyrimet e Kolateralmarresit dhe Kolateraldhënesit

7.1 Kolateralmarresi, në rast të mospërmblotjes nga ana e kredimarresit shoqëria "Griald" Shpk të detyrimeve që rrjedhin nga **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016** të përshkruar me hollësisht në nenin 3.1, ka të drejtë të sekuestrojë pengun pa njoftim, dhe Kolateraldhënesi nuk ka asnjë pretendim lidhur me keto veprime.

7.2 Në rastin kur Kredimarresi është në vonesë > 29 ditë nga dita e pagesës së kësaj **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016** si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime të saj, Kolateralmarresi ka të drejtë dhe Kolateraldhënesi autorizon Kolateralmarresin paraprakisht për të prekur/perdorur drejtpërdrejt pengun e përshkruar me hollësisht në nenin 3 të kësaj kontrate pengut, për të mbuluar keto detyrime.

7.3 Kolateralmarresi ka të drejtën e marrjes së frutave apo të ardhurave të sendit, nëse pengut sjell të ardhura. Kolateralmarresi ka të drejtë të perdorë keto të ardhura për të shlyer detyrimet e siguruarat me këtë kontratë pengut por pa u limituar në keto, si pagimin e kesteve më të mëdha së bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera të parashikuara, **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016**, si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime të saj.

7.4 Kolateralmarresi detyrohet të ruajë sendin e marrë peng dhe përgjigjet, sipas rregullave të përgjithshme për humbjen dhe demtimin e tij.

7.5 Kolateralmarresi është i detyruar që të mos e japë sendin në peng ose t'ua lërë të tjerëve në përdorim.

7.6 Kolateraldhënesi është i detyruar të mos e kerkojë kthimin e sendit, nëse nuk janë paguar teresisht të gjitha detyrimet që rrjedhin nga **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr. 226 kol, date 08.02.2016**, si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime të saj.

7.7 Kolateraldhënesi është i detyruar të paguajë shpenzimet e kryera për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pengut.

7.8 Kolateralmarresi ka të drejtë të kerkojë shtimin e pengut kur ky i fundit është zvogëluar në vlerë dhe Kolateraldhënesi ka detyrimin të shtojë pengun me kërkesën me të parë të Kolateralmarresit.

N e n i 8
Ekzekutimi marreveshjes

8.1 Ne rastin e ndodhjes se nje nga "Rastet e mospermbushjes" te parashikuar ne **Kontrate Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016**, si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj, ose ne rast te shkeljes apo mospermbushjes se ndonje prej dispozitave te kesaj kontrate pengu Kolateralmarresi ka te drejten te deklaroje menjehere si te pagueshme te gjitha detyrimet e siguruara nga kjo kontrate pengu si dhe te mbledhe te gjitha detyrimet se bashku me te gjitha shpenzimet e kryera nga Kolateralmarresi per realizimin dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate pengu.

8.2 Ekzekutimi i kolateralit te vene peng ne baze te kesaj kontrate Pengu i nenshtrohet ekzekutimit te menjehershem nga ana e Kolateralmarresit, pa patur nevoje per te ndjekur ndonje procedure per ekzekutim te detyrueshem permes Gjykates dhe permbauesve gjyqesore.

N e n i 9
Zgjidhja e kontrates

Palet mund ta zgjidhin kete kontrate pengu:

- me marreveshje te dyanshme;
- **Kontrata Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016, ne shumen prej 15.000.000 leke**, si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj ka perfunduar dhe njekohesisht eshte paguar i gjitha detyrimi i kesaj kontrate overdrafti se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera;
- Palet mund te zgjidhin kontraten ne rast se njera prej tyre nuk permbush detyrimet qe rrjedhin prej saj ose kryen shkelje te rende te dispozitave te parashikuara ne kete kontrate. Ne kete rast pala e demtuar ka te drejte te kerkoje demshperblim.

Neni 10
Njoftimi Zyrtar midis Paleve

10.1 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve ne kete kontrate, do te behen me shkrim te dorezuara personalisht ose me poste te regjistruar (rekomande), ne adresen e percaktuar ne kete Kontrate.

10.2 Kolateraldhenesi deklaron dhe pranon qe te gjitha llojet e njoftimeve te bera ne kete adrese do te konsiderohen si te marra nga ai.

10.3 Kolateraldhenesi eshte i detyruar qe te njoftoje menjehere cdo ndryshim ne adresen e tij. Per sa kohe qe ai nuk ka njoftuar adresen e re, njoftimet do te quhen si te bera dhe kredimarresi heq dore nga cdo pretendim ne lidhje me njoftimet e bera ne adresen e meparshme.

N e n i 11
Dispozita te tjera

11.1 Pas hyrjes ne fuqi te kontrates, Kolateraldhenesi deklaron se do t'u bindet termave dhe kushteve te kesaj kontrate, do t'u permbahet obligimeve dhe angazhimeve detyruese, te parashikuara ne kete kontrate pengu si edhe ne **Kontrate Linje Kredie Nr. 2242 /date 05.02.2016, nr. 503 rep, nr.226 kol, date 08.02.2016**, si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj e siguruar me kete kontrate pengu.

11.2 Palet do te zgjidhin me mirekuptim cdo konflikt qe ka per baze kete kontrate, perndryshe, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

11.3 Cdo gje tjeter ne marredheniet midis paleve te kesaj kontrate, e pa permendur ne kete marreveshje, do te zgjidhet sipas dispozitave te neneve 530 e vijues, nenet 546 e vijues dhe nenet 681 e vijues te Kodit Civil, dhe legjislacionit te aplikueshem per te rregulluar kete marredhenie kontraktore.

Kjo kontrate u hartua ne 3 (tre) kopje origjinale, me permbajtje te njejte dhe palet shprehen se perputhet me vullnetin e tyre te plote, nenshtktohet prej tyre .

PALET KONTRAKTUESE

KOLATERALMARRESI


"BANKA CREDINS" SH.A
Drejtore Rajoni Tirana I
Blerta TELA

Blerta TELA

Analiste Kredite SME

Lusena GJONEDAJ

Lusena Gjonedaj



KOLATERALDHENESI

Gezim HALILI


Gezim Halili

Albana HALILI

Albana Halili

NOTER

Ermer Hamzaj



[Signature]

